

20110511421

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BIBLIOTEKA

Neni 1

Në Ligjin për biblioteka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 66/2004, 89/2008 dhe 116/10), neni 8 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Themeluesi i bibliotekës dorëzon kërkesë për fillimin e punës së bibliotekës në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e kulturës, me dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafi (1) i këtij neni."

Pas paragrafit (2) shtohen 18 paragrafë të rinj (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19) dhe (20), si vijojnë:

"(3) Për plotësimin e kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkeses nga paragrafi (2) i këtij neni, e pas mendimit paraprak nga biblioteka amë miraton aktvendim.

(4) Nëse ministri nuk miraton aktvendim për plotësimin e kushteve të veçanta për fillimin e punës të bibliotekës, perkatesisht nuk e refuzon kërkesën për miratim të aktvendimit për plotësimin e kushteve të veçanta për fillimin e punës të bibliotekës në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri ditëve të punës, në sekretarinë e ministrit të paraqesë kërkesë për plotësimin e kushteve të veçanta për fillimin e punës të bibliotekës dhe ministri të miratojë aktvendim.

(5) Formen dhe përmbajtjen e formularëve të kërkesave nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni, i përcakton ministri.

(6) Ministri detyrohet që në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e paraqitjes së kërkesës nga paragrafi (4) i këtij neni në sekretarinë e ministrit, të miratojë aktvendim me të cilin kërkesa për plotësimin e kushteve të veçanta për fillimin e punës të bibliotekës pranohet, perkatesisht refuzohet. Nëse ministri nuk ka sekretari, kërkesa dorëzohet në sekretarinë e selisë së organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e kulturës.

(7) Me kërkesën për miratimin e aktvendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës dorëzon edhe kopje të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Nëse ministri nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë ditëve të punës.

(9) Inspektorati Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimin të njoftimit nga paragrafi (8) i këtij neni, të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e kulturës nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta njoftojë parashtruesin e kërkesës.

(10) Inspektori pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligjin, miraton aktvendim me të cili e ngarkon ministrin që afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e paraqitur, perkatesisht ta pranojë ose refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje e aktit me të cilin ministri ka vendosur për kërkesën e paraqitur.

(11) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (10) i këtij neni, inspektori do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të percaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin ministri do të vendosë për kërkesën e paraqitur për çfarë në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dorëzohet kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e paraqitur. Inspektori në afat prej tri ditëve të punës e informon parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditëve të punës, do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në atë afat, do ta informojë parashtruesin e kërkesës.

(13) Nëse inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditëve të punës ka të drejtë që të parashtrojë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Shtetëror Administrativ. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarinë e selisë së Inspektoratit Shtetëror Administrativ.

(14) Drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ është i obliguar që në afat prej tri ditëve të punës nga dita e pranimit, ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (13) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkesës nga paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni, ose nuk paraqet kallëzim në pajtim me paragrafët (11) dhe (12) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditëve të punës, në të cilin inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e kulturës nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri ditëve të punës nga dita e mbikëqyrjes së kryer, ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ do të paraqesë kallëzim te prokurori publik kompetent kundër inspektorit dhe në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(16) Në rastin nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ, menjëherë, e më së voni në afat prej një ditë pune do të autorizojë inspektor tjetër që ta kryejë mbikëqyrjen menjëherë.

(17) Në rastet nga paragrafi (16) i këtij ligji, drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ në afat prej tri ditëve të punës do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(18) Nëse drejtori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (14) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrojë kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditëve të punës.

(19) Nëse ministri nuk vendosë në afatin nga paragrafi (12) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(20) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente."

Paragrafi (3) i cili bëhet paragraf (21) ndryshohet si vijon:

"(21) Kunder aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë".

Paragrafi (4) bëhet paragraf (22).

Neni 2

Në nenin 10 paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"Kunder aktvendimit nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni mund të paraqitet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë".

Neni 3

Në nenin 12 paragrafi (9) fjalët: "Komisionin e shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, kompetent për zgjidhjen e çështjeve nga sfera e marrëdhënieve të punës" zëvendësohen me fjalët: "Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë".

Neni 4

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Pas publikimit të aktit nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ai menjëherë, e më së voni në afat prej 24 orësh publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës.

Neni 5

Procedurat për marrjen e aktvendimit për përmbushjen e kushteve të veçanta për fillimin e punës të bibliotekës, të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas Ligjit për biblioteka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 66/2004, 89/2008 dhe 116/10).

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave të nenit 1 të këtij ligji, që kanë të bëjnë me nenin 8 paragrafi (21) të këtij ligji dhe nenet 2 dhe 3 të këtij ligji, që do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marredhenie të Punës në Shkallë të Dytë.